



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 872/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Zyhdi Haziri kryesuese, Rrustem Thaqi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, duke vendosur përkritazi me apelin e kandidatit për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Afrim Gashi nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur me datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli Anr.872/2021 i datës 04.11.2021 i parashtruar nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Afrim Gashi nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit me numër 2948/2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.11.2021 nga kandidati për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Prishtinës Afrim Gashi nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me të cilën pretendon se një numër i konsiderueshëm i votave i janë prishur dhe i janë tjetërsuar ne të gjitha vendvotimet ne komunën e Prishtinës, bazuar ne faktet e shume fletëvotimeve te pa vlefshme ku sipas parashtruesit te apelit kanë te bëjnë me numrin e tij. Si dëshmi ka bashkangjitur deklaratat e disa personave për të cilët pretendon se e kane votuar për të.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se në cilat vendvotime janë bërë parregullsi, duke mos treguar se sa vota i mungojnë ashtu siç pretendon, por vetëm i përmend disa emra të disa shkollave si dhe ka bashkangjitur disa deklarata të disa personave me emër, mbiemër dhe me numër personal për

të cilët thekson se këta votues kanë votuar për të, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtruar e konsideron si të përgjithësuar dhe të pa bazuar në fakte, dëshmi të qarta dhe bindëse pasi që parashtruesi i apelit nuk e ka specifikuar asnjë vendvotim, sepse vendvotimet në të cilat zhvillohet votimi janë të përcaktuara me numra përkatës, e për të cilën pala ankuese nuk i ka shënuar numrat e tyre, edhe pse barra e të provuarit bie mbi parashtruesin e apelit konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.872/2021 më datën 07.11.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.